



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Drejtor i Departamentit Ligjor
Klasa e pozitës	Drejtues i Mesëm 1
Koeficienti/Paga	10
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	05/07/2022
Afati për aplikim	20/07/2022 - 27/07/2022
Institucioni	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
Departamenti	Departamenti Ligjor
Divizioni	
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00009378
Kodi	RPC0003120



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Mbështet dhe ofron këshilla për Drejtorin e Institucionit për zbatimin e drejtpërdrejtë të Ligjit ose ofrimin e shërbimeve të caktuara në fushën e përgjegjësisë së departamentit;
- Drejton dhe mbikëqyr të gjitha aktivitetet e departamentit ligjor dhe siguron funksionim efikas të tij.
- Udhëheqë procedurën e Lëshimit të Licencave/Lejeve në pajtim me vendimet e Bordit të KPMM-së.
- Udhëheqë procedurën e Lëshimit të Licencave/Lejeve në pajtim me vendimet e Bordit të KPMM-së.
- Organizon dhe shpërndan punën për varësit e tij dhe menaxhon realizimin e detyrave dhe përgjegjësi që duhen përmbushur në përputhje me objektivat dhe përgjegjësit e departamentit;
- Udhëheq dhe mbikëqyr procedurat gjyqësore që zhvillohen ku palë është KPMM;
- Udhëzon stafin në përmbushjen e aktiviteteve të përditshme të departamentit dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin, politikat institucionale dhe standardet përkatëse;
- Me autorizimin të mbikëqyrësit, përfaqëson institucionin në takime pune, konferenca në fushën e përgjegjësisë së departamentit të cilin e udhëheq;
- Përgatiti dhe udhëheqë punën në hartimin e rregulloreve, direktivave, dhe udhëzimeve sipas vendimeve të Bordit, duke përfshirë legjislacionin sekondar minerar sa i përket fushës juridike minerar si dhe mbrojtjes në punë në sektorin e minierave.
- Merr pjesë në organe kolegjiale për trajtimin e kërkesave apo ankesave drejtuar KPMM-së.
- Përgatiti dhe udhëheq që punën në hartimin e rregulloreve, direktivave, dhe udhëzimeve sipas vendimeve të Bordit, duke përfshirë legjislacionin sekondar minerar sa i përket fushës juridike minerar si dhe mbrojtjes në punë në sektorin e minierave.
- Bën vlerësimin e rezultateve të punë për stafin nën mbikëqyrje të tij/saj dhe identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve të stafit të tij.
- Siguron që stafi i departamentit ligjor të jetë i njoftuar për çdo dokumentacion, apo informacion të pranuar në KPMM, të cilat i përkasin detyrave të stafit dhe delegon detyrat sipas rregullave të përcaktuara me aktet ligjore dhe nënligjore të KPMM-së.
- Harton raportin vjetor për Departamentin Ligjor si dhe në raste të veçanta sipas kërkesës së Drejtorit dhe Bordit harton raporte për ndërmarrjet të cilat janë në procedura gjyqësore me KPMM-në apo institucionet e tjera.
- Përgatit dhe udhëheqë Departamentin në hartimin e raporteve ligjore për aplikacionet për licenca/leje për Bordin e KPMM-së;
- Detyra të tjera – juridike dhe ligjore në përputhje me ligjet dhe rregulloret – të cilat me arsye mund të kërkohen nga Drejtori i KPMM-së dhe Bordi.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Diplomë të studimeve universitare në Fakultetin Juridik me të paktën 240 kredi/ECTS (sistemi 4 vjeçar) apo Diplomë Bachelor të studimeve universitare në Fakultetin Juridik me 180 kredi/ECTS (sistemi 3 vjeçar) me kusht që të ketë të përfunduar studimet Master në Fakultetin Juridik.
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- Trajnime nga fusha juridike-administrative në shërbimin civil. (Të dëshmuara me certifikata)
- Së paku 5 vite përvojë pune profesionale juridike, me të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e sektorit të minierave ose/apo energjisë.
- Dëshmia për përvojën e punës duhet dëshmuar me pasqyrën e llogaris nga Trusti ose Qarkores ne fuqi.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe formulim politikash;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioritetëve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve;
- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën e legjislacionit në sektorin e minierave;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale të fushës në sektorin e minierave dhe të kuptuarit të fushave së administratës publike dhe gjyqësorit për shkak që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit e pozitës;
- Njohuri të gjera të fushës juridike, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Njohja e gjuhës angleze apo gjuhëve të tjera që gjejnë zbatim në Republikën e Kosovës është përparësi.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.



6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 03/08/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- Zyret e KPMM-ës, Prishtinë

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

- Diploma Universitare
- Trajnime nga fusha e kerkuara
- Pervoja e punes

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

